



## In medias res

### Llojet e komunikimit me adoleshentë

*“Nëse ke dituri, lejo të tjerët të ndezin qirinj në ty”*

Margaret Fuller

Komunikimi dhe llojet e komunikimit janë qirinj që ndizen në lumturinë e përbashkët të adoleshentëve.

Të rriturit shpesh u flasin adoleshentëve duke mos menduar nëse ata kuptojnë atë çka u thuhet. Andaj, të provojmë të bëhemi të ditur në mënyrën se si fëmijët/adoleshentët do ta kenë më lehtë t'i ndezin ata qirinj dhe të përfitojnë dituri.

Shumë komunikime bëhen pa biseduar fare. Shprehja e fytyrës së personit, lëvizjet, toni i zërit - të gjitha janë këto komunikime, kuptimi i të cilave varet nga kultura e tyre e caktuar. Ky lloj komunikimi është komunikim joverbal dhe është më se e rëndësishme të dihet nëse fëmija apo adoleshenti ndihet më mirë në këtë mënyrë.

Nëse dukemi të mërralor, të brengosur apo të mërzitur derisa fëmija na flet, atëherë, ata ndalen së foluri. Inkurajimi i zhurmës, mimikës dhe të qeshurit tregon interesimin e të rriturve për atë se çfarë dëgjojnë nga fëmijët.

Shakatë, mahitë dhe buzëqeshjet mund të ndihmojnë fëmijën të relaksohet dhe të fillojë besimin. Kulturat ndryshojnë për nga ajo se si pritet nga adoleshentët të sillen në prezencën e të rriturve. Adoleshentët duhet të zgjedhin mënyrën se si dëshirojnë të komunikojnë me një të rritur, përndryshe komunikimi do të dështojë.

Po ashtu, me rëndësi të veçantë është edhe mënyra se si iu parashtrijmë pyetjet adoleshentëve duke u munduar që të parashtrijmë vetëm një pyetje në të njëjtën kohë.

Nuk do të thotë që bisedën me adoleshentë ta zhvillojë vetëm prindi apo kujdestari i fëmijës. Në rastet e tilla duhet të krijojmë atmosferë të këndshme në mënyrë që ata ta ndiejnë veten të sigurte dhe të fitojnë besimin te personi me të cilin do të flasin, sepse, ka raste kur adoleshenti kërkon që biseda të jetë konfidenciale. Andaj, për të fituar besimin, të rriturit duhet të tregojnë interesim të ngrohtë dhe të sinqertë lidhur me jetën, shpresat dhe vështirësitë e një fëmije/adoleshenti.

Durimi që duhet pasur të rriturit gjatë komunikimit me adoleshentë, është një nga kualitetet më të rëndësishme. Sjellja të cilën e tregojnë të rriturit në jetën e përditshme dhe marrëdhënia e tyre me adoleshentët është elementi kyç që ndihmon në krijimin e atmosferës së qetë dhe relaksuese për komunikim.

Pra, komunikimi është proces i dyanshëm. Duhet ti kushtohet vëmendje personit me të cilin flasim. Të bëhemi dëgjues të mirë. Të jemi të vetëdijshëm për komunikimin të cilin e bëjmë. Të përdorim gjuhë të thjeshtë. Të përdorim pyetje të hapura dhe të sigurohemi se jemi të kuptuar.

*Shkroi: Ardita Kabashi-Hima*

## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

■ Në kuadër të Programit të MKLSh më 23 maj 2007 është bërë certifikimi i 40 mësimeve të Sh.f. "Hasan Prishtina" në Prishtinë, pasi ata kanë plotësuar të gjitha standardet e Programit të MKLSh-së. Pjesëmarrësit kanë vijuar në mënyrë të rregullt të gjitha seminarët, kanë bashkëpunuar me trajnerët për të realizuar orët e monitorimit, si dhe kanë përgatitur dosjet me punime të nxënësve. Është e rëndësishme të ceket se trajnimi është bërë me vetëfinancim, ndërsa KEC në këtë rast ka ndihmuar këtë iniciativë me ofrimin falas të kompletit të udhëzuesve 1-8 të Programit të MKLSh-së për secilin pjesëmarrës.

■ Më 26 dhe 27 maj 2007 është mbajtur seminari i 6 me titull "Planifikimi dhe vlerësimi" për 30 mësimeve të gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë. Pjesëmarrësit janë njoftuar se seminari i 7 dhe i fundit do të mbahet gjatë pjesës së parë të muajit qershor, me ç'rast pjesëmarrësit e suksesshëm do të certifikohen.

### EKK

#### (Edukimi kundër korrupsionit)

■ Gjatë muajit maj ka vazhduar monitorimi i mësimeve të regjionit të Prizrenit dhe Gjilanit, të cilët gjatë muajit prill kanë vijuar seminarin "Edukimi kundër Korrupsionit". Monitorimi i mësimeve në klasa ka pasur për qëllim vlerësimin e performancës së mësimeve në zbatimin e idesë së luftës kundër korrupsionit në kurrikulin e lëndës së tyre. Pas përfundimit me sukses të monitorimit, certifikimi i mësimeve në Prizren dhe Gjilan u bë më 17 maj 2007.

■ Gjatë muajit maj janë organizuar në Istog dhe Suharekë aktivitete në kuadër të "Javës së luftës kundër korrupsionit". Gjatë kësaj jave janë organizuar aktivitete garuese për nxënësit në lëmi të poezisë, esesë, pikturës, vizatimit etj. dhe janë shpërblyer nga komisionet profesionale nxënësit më të suksesshëm. Po ashtu janë organizuar dhe tryeza të rumbullakëta, në të cilat është potencuar rëndësia e arsimit si njëra ndër strategjitë më efikase për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Aktivitete të tilla do të organizohen dhe në komunat tjera.

### Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

■ Më 28-29 maj 2007 në Prishtinë është mbajtur trajnimi me titull "Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin". Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues të MASHT, Ministrisë së Drejtësisë, DKA, ZRA, Drejtorë shkollash dhe institucioneve parashkollore, si dhe përfaqësues të OJQ-ve, të cilat veprojnë në regjionin e Prishtinës.

Në fund të trajnimit më 29 maj 2007, në lokalet e KEC, u bë certifikimi i 20 pjesëmarrësve.



■ Më 30-31 maj 2007 në sallën e Kuvendit Komunal në Prizren është mbajtur trajnimi

me titull “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin”. Në këtë trajnim morën pjesë 38 përfaqësues të Kuvendit Komunal të Prizrenit, drejtorë shkollash, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të Institucioneve Qendrore, si dhe përfaqësues të mediave. Trajnimi u zhvillua në një atmosferë të jashtëzakonshme. Pjesëmarrësit ishin shumë të përgatitur, gjë që bëri që trajnerët gjatë gjithë kohës, të jenë të detyruar ti zgjasin seancat e trajnimit. Vërtetë, trajnimi në Prizren ishte i një cilësie të lartë, falë bashkëpunimit të mirë të pjesëmarrësve dhe trajnerëve. Numri prej 36 pjesëmarrësve të rregullt dhe prezenca e vazhdueshme e mediave bënë që trajnimi në Prizren të jetë më i suksesshmi që nga fillimi i zbatimit të programit të tillë të trajnimit në Kosovë. Pyetjet dhe komentet e pjesëmarrësve ishin të qëlluara dhe në funksion të sensibilizimit të qytetarëve për nevojën e domosdoshme të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në Kosovë. Nga trajnimet dolën edhe rekomandime të fuqishme, njëra nga të cilat është edhe kërkesa për ndryshimin e Ligjit kundër korrupsionit. Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet më 6 qershor 2007.

## **Edukimi për të Drejtat e Fëmijës**

■ Në kuadër të programit “Edukimi për të drejtat e fëmijës”, janë zhvilluar një varg aktivitete. Këto aktivitete janë bërë me nxënësit e shkollës jo publike “Mileniumi i Tretë”.

### ***Vizita në “Shtëpinë Korrektuese”, në Lipjan.***

■ Me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për ligjin, rregullat dhe ndëshkimet për

ata të cilët e shkelin ligjin, nxënësit e shkollës “Mileniumi i Tretë” kanë bërë një vizitë në “Shtëpinë Korrektuese”, në Lipjan. Fëmijët janë njohur më afër me kushtet, rregullat dhe jetën e të miturve të cilët gjinden në atë shtëpi korrektuese. Pas vizitës në këtë qendër, fëmijët kanë pasur rastin të takohen edhe me Drejtorin e kësaj qendre Z. Valon Maxharraj, i cili u mbajti nxënësve një seancë të shkurtë për kushtet dhe jetën e të miturve në Lipjan. Po ashtu edhe nxënësit patën mundësi të shtrojnë pyetje dhe të marrin informacione të shumta në lidhje me ligjin dhe mbrojtjen e tyre si fëmijë.

### ***Ndihma humanitare***

■ Pasi që është bërë identifikimi i pesë familjeve të varfra në Rajonin e Prishtinës, nxënësit e shkollës “Mileniumi i Tretë”, u ndihmuan këtyre familjeve me gjëra të ndryshme ushqimore. Nxënësit premtuan se ndihmat e tilla nuk do ti ndalin asnjëherë.

Ndihmat u janë ndarë moshatarëve të tyre të cilët nga kushtet e vështira të jetës, janë të detyruar që pas mësimit të punojnë në mënyrë që sado pak të ju ndihmojnë familjeve të tyre.



### ***Punëtori***

■ Gjatë Panairit të librit që u mbajt në Prishtinë, nxënësit e shkollës Mileniumi i Tretë janë ftuar në një punëtori të mbajtur

nga Shtëpia Botuese - "Rrota". Në këtë punëtori, nxënësit u mësuan të shkruajnë me hieroglifë. Të gjithë nxënësit shkruan mesazhe të ndryshme për shkollën, ndërsa kjo shtëpi botuese do ta bëjë zgjedhjen e mesazhit më të mirë dhe do ta boton në numrin e ardhshëm të revistës "Pishpiriku". Poashtu, mesazhi më i mirë i shkruar me hieroglifë, do të shpërblehet nga kjo shtëpi botuese.



### ***Komiteti shkollor***

■ Më 22 maj, nxënësit nga Komiteti i shkollës "Mileniumi i Tretë", janë ftuar si mysafir në debatin e mbajtur nga Komiteti shkollor i shkollës fillore "Hilmi Rakovica në Prishtinë.

Tema e debatit ishte: "Ambienti dhe Energjitë e ripërtrishme". Nxënësit e shkollës „Hilmi Rakovica“ bënë prezantimin e kësaj teme. Më pas u hap debati. Të ftuar në këtë debat kishte përfaqësues të „Resource Center“, Profesorë nga "Penn State University", Profesor nga UP, Përfaqësues të KFOR-it, SHPK-së dhe nxënës.

■ Me 30 maj, në KEC ishte për vizitë Znj. Niamh Gaynor. Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i programit "Edukimi për të Drejtat e Fëmijës", projekt ky i financuar nga TROCAIRE.

Znj. Niamh Gaynor qëndroi tri ditë. Gjatë këtyre ditëve ajo pati shumë takime me bashkëpunëtorë të ndryshëm të këtij projekti, me qëllim që të bëjë vlerësimin e

projektit. Takimet filluan me shkuarjen në Prizren ku pati rastin të takohet me Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe Komitetin e shkollës "Abdyl Frashëri" të Prizrenit. Me pas, takimet e saj vazhduan në Zyrën Rajonale dhe Kryqin e Kuq, me seli në Prizren.

Dita e dytë vazhdoi me takimet në MASHT, në Fakultetin e Edukimit, organizatën ABA CEELI. Ajo pati takime gjithashtu edhe me drejtorin e KAHCR, dhe me drejtorin e Shtëpisë Korrektuese në Lipjan.

Dita e tretë vazhdoi me takimet në Gjakovë. Edhe atje pati rastin të takohet me këshilltarë dhe nxënës të Komiteteve shkollore. Meqenëse ishte 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e fëmijëve, aktivitetet e shumta të organizuara në Gjakovë, ishin një dëshmi, shtesë për vlerësuesen nga Irlanda.

### **“Edukimi Multikulturor dhe Multietnik“**

■ Ne kuadër të programit “Edukimi Multikulturor dhe Multietnik” u mbajt Moduli i dytë dhe Moduli i tretë i trajnimit për trajner. Në fund të trajnimit, përkatësisht me datën 26 maj u bë certifikimi i 19 pjesëmarrësve, të cilët do të jenë trajner për Edukimin Multikulturor dhe Multietnik“.

Në mesin e tyre, kishte edhe pjesëtarë të komunitetit turk dhe boshnjak.



Këto dy module janë udhëhequr nga Z. Halim Hyseni - koordinator i programeve të KEC dhe Z. Avni Dalipi - koordinator i organizatës „Qeshu-Smile“.

## **Stereotipet gjinore në tekstet shkollore**

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar edhe aktivitetet e fundit të cilat e përmbyllën ciklin e aktiviteteve të këtij projekti. Të gjitha hulumtimet e kërkuara nga donatorët janë bërë, janë përkthyer në gjuhën angleze dhe i janë dërguar donatorëve për botim.



Më 12 dhe 13 Maj, është mbajtur Konferenca rajonale në Tivat - Mal të Zi, ku ishin prezent përfaqësuesit të këtij projekti. Në Konferencë është bërë prezantimi i hulumtimeve nga secili shtet dhe janë definuar aktivitetet e mëtutjeshme për vazhdimin e këtij projekti.

## **Hap pas Hapi**

■ Gjatë muajit maj kanë filluar trajnimet për shkollat fillore.

Në Pejë nga data 11-19 maj është mbajtur trajnimi fillestar për klasën e I-rë. Në trajnimi morën pjesë 30 pjesëmarrës.

■ Me 17 maj është mbajtur takimi me Kontakt personat e kopshteve. Temë e këtij takimi ishte “Kurrikuli për edukimin parashkollor dhe metodologjitë e reja të punës”. Takimi u mbajt në Vushtrri në kopshtin “Foleja”. Përveç kontakt personave të Institucioneve parashkollore, të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi, në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të kopshteve private.

■ Me 16 maj u mbajt pjesa e dytë e trajnimit për monitorët (mentorët) e programit Hap pas Hapi për klasat parashkollore dhe shkollat fillore. Të gjithë monitorët patën mundësi të ushtrojnë monitorimin sipas standardeve të programit Hap pas Hapi duke i shfrytëzuar instrumentet përkatëse në klasat e shkollave fillore ku punohet me metodologjinë Hap pas hapi.

## **Edukimi për të drejtën shoqërore**

■ Gjatë muajit maj, në tri qendra të Kosovës: Ferizaj, Gjilan dhe Pejë, është mbajtur trajnimi treditör Edukimi për të Drejtën Shoqërore, organizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës.

Në këtë trajnim morën pjesë kryesisht mësuesit të arsimit fillor dhe të mesëm nga këto regjione, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Pjesëmarrësve iu është prezantuar Moduli i parë, i cili ka si synim ngritjen e njohurive për paragjykimet, stereotipet, shtypjet dhe format e shtypjes, mënyrën e krijimit të tyre si dhe strategjitë për ndryshim të qëndrimeve dhe sjelljeve, të cilat janë krijuar ndaj individëve dhe grupeve tjera. Pjesëmarrësit që kanë ndjekur Modulin e parë, do të kenë mundësinë të përfshihen edhe në Modulin e dytë. Sipas programit, Moduli dy duhet të mbahet pas 4 muajve distancë.



Të gjithë pjesëmarrësit kanë vlerësuar këtë trajnim si shumë të dobishëm dhe me vlerë. Veçantia e këtij trajnimit qëndron te ndërlidhja e teorisë me praktikën, që i bënë pjesëmarrësit aktiv gjatë gjithë kohës.

## **ACCESS Microscholarship Program**

Në muajin maj, përfundoi viti i parë i programit ACCESS Microscholarship Program. Ky program dyvjeçar financohet nga Zyra Amerikane në Kosovë dhe implementohet nga KEC. Në kuadër të këtij programi, nxënësit kanë thelluar njohuritë për gjuhën angleze, historinë dhe kulturën e popullit amerikan. Gjatë këtij muaji, janë organizuar edhe aktivitete të ndryshme sociale të cilat kanë pasur për qëllim socializimin e nxënësve të grupeve ndryshme etnike dhe rritjen e bashkëpunimit mes tyre.



Me rastin e përfundimit të vitit të parë, 60 nxënës janë certifikuar për pjesëmarrje në këtë program.

Viti i dytë i programit ACCESS Microscholarship fillon nga mesi i muajit Shtator.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*